



PROGRAMI I MASSACHUSETTS-IT PËR VAKSINËN KUNDËR COVID-19

Vaksina kundër COVID-19:

Pyetje që bëhen shpesh

Përditësuar më 26 gusht 2022

[Pyetje që bëhen shpesh rreth vaksinës kundër COVID-19 | Mass.gov](#)

Tryeza e lëndës

- [Para se të vaksinoheni](#)
- [Gjatë vizitës suaj](#)
- [Pasi të vaksinoheni](#)
- [Siguria e vaksinës](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Para se të vaksinoheni

A do të duhet të paguaj për vaksinën?

Jo. Vaksina u ofrohet falas të gjithëve, nga qeveria federale. Në qoftë se jeni të siguar, fatura do t'ju dërgohet sigurimit tuaj shëndetësor pa asnjë kosto për ju. Megjithatë, ju nuk ka nevojë të jeni të siguar, për ta bërë vaksinën. Nuk do t'ju kërkohet kurrë një numër karte krediti, për të lënë një takim vaksinimi.

A mund ta marrin vaksinën falas imigrantët e padokumentuar?

Po. Vaksina vetë është falas për të gjithë individët në Massachusetts. Sigurimet shëndetësore (përfshi Medicare dhe Medicaid) do të mbulojnë koston e dhënies së vaksinës. Për pacientët pa sigurime shëndetësore, ofruesit e kujdesit shëndetësor mund të kërkojnë rimbursim nga qeveria federale për koston e vaksinimit të imigrantëve të padokumentuar.

A mund të vaksinohem edhe sikur të mos kem një kartë ID?

Po. Mund ta bëni vaksinën edhe po të mos jeni i siguar, po të mos keni patentë automjeti ose numër të sigurimit shoqëror. Për më shumë informacion, vizitoni [Si të përgatiteni për takimin tuaj të vaksinimit kundër COVID-19](#).

A do të ketë vaksinimi ndikim negativ ndaj statusit të imigracionit të dikujt?

Jo. Qeveria federale ka konfirmuar se nuk do ta konsiderojë trajtimin kundër COVID-19 (përfshi këtu vaksinën) si faktor në përcaktimin nëse dikush përbën "shpenzim publik" ose siç ndërlidhet me gjendjen e përfitimit publik për disa persona që kërkojnë një shtyrje qëndrimi ose ndryshim statusi, edhe sikur vaksina të paguhet nga Medicaid ose fonde të tjera federale.

A është e mbrojtur privatësia e kartelës së vaksinimit të një pacienti?

Departamenti i Shëndetit Publik do të mbajë një kartelë elektronike për çdo pacient në Massachusetts që vaksinohet kundër COVID-19. Databaza e vaksinave do të mbahet në fshehtësi, njëlloj si kartela mjekësore e pacientit te mjeku përkatës.

A do të duhet të testohem për COVID-19 para se të vaksinohem?

Jo, nuk është nevoja të bëni një test COVID-19 para se të vaksinoheni.

Nëse jam i pavaksinuar, por tashmë e kam kaluar COVID, a duhet të vaksinohem akoma?

Po. Ju duhet të merrni një vaksinë COVID-19 edhe nëse keni kaluar tashmë COVID-19. Asnjë test i disponueshëm aktualisht nuk mund të përcaktojë me siguri nëse jeni të mbrojtur pasi jeni infektuar me virusin që shkakton COVID-19. Megjithatë, ju *mund* të konsideroni shtyrjen e dozës së ardhshme të vaksinës (doza primare ose përforcuese) me 3 muaj nga fillimi i simptomave tuaja ose, nëse nuk keni pasur simptoma, kur keni marrë për herë të parë një përgjigje pozitive të testit.

Marrja e një vaccine për COVID-19 pasi keni pasur COVID-19 siguron mbrojtje shtesë për sistemin tuaj imunitar. Njerëzit që kishin tashmë infeksionin COVID-19 dhe nuk vaksinohen pas shërimit të tyre kanë më shumë gjasa të marrin përsëri COVID-19 sesa ata që vaksinohen pas shërimit të tyre.

Personat që mund të presin të vaksinohen

Sa kohë duhet të pres për t'u vaksinuar pasi të kem kaluar COVID-in?

Duhet të prisni deri në 10 ditë pas fillimit të simptomave ose, nëse nuk keni pasur simptoma, 10 ditë pasi testi juaj ka dalë pozitiv. Kjo për të siguruar që ju të mos përhapni COVID-19 te të tjerët.

Nëse keni kaluar së fundmi COVID-19, *mund* të konsideroni shtyrjen e vaksinës suaj të radhës për COVID-19 (qoftë doza primare ose përforcuese) me 3 muaj nga fillimi i simptomave tuaja ose kur keni marrë një test pozitiv.

A duhet të vaksinohem akoma nëse kam marrë një trajtim me antitropa monoklonalë për COVID? Sa kohë duhet të pres për të vaksinuar pas trajtimit?

Po. Sipas CDC, individët që kanë marrë antitropa monoklonale për trajtimin e COVID-19 duhet të vaksinohen dhe nuk kanë nevojë të presin për të marrë një vaksinë COVID-19.

A mund ta bëjnë vaksinën kundër COVID-19 në Massachusetts ata që jetojnë në një shtet tjetër ose jashtë Amerikës *part time* (p.sh., studentë, pensionistë, persona me shtetësi të dyfishtë)?

Po. Programi i vaksinimit kundër COVID-19 në Massachusetts mbulon individë që jetojnë, punojnë ose studiojnë në Commonwealth. Ju mund edhe ta merrni dozën e dytë në Massachusetts po ta keni marrë dozën e parë në një shtet tjetër. Sigurohuni që ta ruani kartën e vaksinimit që ju kanë dhënë, kur morët dozën e parë.

Ç'përfitime sjell vaksinimi kundër COVID-19?

Vaksinat e COVID-19 të disponueshme në Shtetet e Bashkuara janë efektive në mbrojtjen e personave - veçanërisht atyre që kanë kryer dozat përforcuese - nga sëmundja serioze, shtrimi në spital dhe madje edhe vdekja. Ashtu si me sëmundjet e tjera, ju mbrohni më së miri nga COVID-19 kur qëndroni të përditësuar me vaksinat e rekomanduara.

Së bashku, vaksinimi kundër COVID-19 dhe ndjekja e rekomandimeve të CDC [për të mbrojtur veten dhe të tjerët](#) do të ofrojnë mbrojtjen optimale ndaj COVID-19.

Si do të punojnë vaksinat kundër varianteve të COVID-19?

Viruset ndryshojnë vazhdimisht përmes mutacioneve dhe ndonjëherë këto mutacione rezultojnë në një variant të ri të virusit. Disa variante shfaqen dhe zhduken, ndërsa të tjerët mbeten aktivë. Variantet e reja do të vazhdojnë të shfaqen. CDC dhe organizata të tjera të shëndetit publik monitorojnë të gjitha variantet e virusit që shkakton COVID-19 në Shtetet e Bashkuara dhe globalisht. Mësoni më shumë te [Rreth varianteve të virusit që shkakton COVID-19 | CDC](#).

Cili është ndryshimi midis autorizimit të përdorimit emergjent dhe miratimit të plotë?

Përpara se vaksinat të vihen në dispozicion të njerëzve në botën reale, FDA vlerëson gjetjet nga provat klinike. Të katër vaksinat COVID-19 të disponueshme në SHBA përmbushnin standardet e sigurisë dhe efektivitetit të FDA-së dhe ato kanë marrë [miratimin e Autorizimit të Përdorimit Emergjent \(EUA\)](#). EUA-të lejuan që vaksinat të shpërndareshin shpejt për përdorim duke ruajtur të njëjtat standarde të larta sigurie të kërkuara për të gjitha vaksinat. Mësoni më shumë në këtë [video rreth EUA-ve](#).

FDA tani ka dhënë miratimin e plotë për [përdorimin e vaksinës së Pfizer-BioNTech \(COMIRNATY\) për COVID-19](#) për personat e moshës 12 vjeç e lart dhe për vaksinën Moderna (Spikevax) COVID-19 për personat 18 vjeç e lart. Përpara dhënies së miratimit, FDA shqyrtoi provat që bazoheshin në të dhënat dhe informacionin e paraqitur për të mbështetur EUA. Kjo përfshinte të dhëna dhe informacione të provave paraklinike dhe klinike, si dhe detaje të procesit të prodhimit, rezultatet e testimit të vaksinës për të siguruar cilësinë e vaksinës dhe inspektimet e vendeve ku është bërë vakina. Këto vakina u zbuluan se plotësojnë standardet e larta për sigurinë, efektivitetin dhe cilësinë e prodhimit që kërkon FDA për një produkt të miratuar. Mësoni më shumë rreth [procesit të miratimit të FDA-së](#).

Unë jam vaksinuar për COVID-19 jashtë Shteteve të Bashkuara. A duhet të rivaksinohem në SHBA me një seri tjetër fillestare? A mund ta përfundoj serinë time të vaksinimit këtu në SHBA? A kam të drejtë për një dozë përforcuese?

Varet nga statusi i shëndetit tuaj, se cilën vaksinë keni marrë dhe nëse keni marrë një seri të plotë fillestare.

Për mbrojtjen më të mirë, CDC rekomandon që të gjithë të qëndrojnë të përditësuar me vaksinat e COVID-19, duke përfshirë njerëzit që kanë marrë një vaksinë COVID-19 jashtë Shteteve të Bashkuara. Një person është i përditësuar me vaksinimin e tij kundër COVID-19 kur ka marrë të gjitha dozat në serinë parësore dhe të gjithë përforcuesit e rekomanduar, kur është i përshtatshëm.

Rekomandimet specifike për personat e vaksinuar jashtë Shteteve të Bashkuara (të paraqitura më poshtë) varen nga fakti nëse:

- Vaksinat e marra janë të pranuar në Shtetet e Bashkuara
- Seritë fillestare janë përfunduar
- Një dozë përforcuese është marrë

Për më shumë informacion, vizitoni [Vaksinat kundër COVID-19 për personat e vaksinuar jashtë Shteteve të Bashkuara | CDC](#)

Gjatë vizitës suaj

Çfarë do të ndodhë gjatë vizitës sime për t'u vaksinuar kundër COVID-19?

Vizitoni [Si ta bëni vaksinën kundër COVID-19 | CDC](#) për këshilla se çfarë mund të prisni të ndodhë kur të vaksinoheni, çfarë informacionesh do të merrni nga ofruesi dhe për burimet që mund të përdorni për të monitoruar shëndetin tuaj pasi të vaksinoheni.

A duhet të mbaj maskë kur të vaksinohem për COVID-19?

Po, gjatë takimit duhet të mbani një maskë që t'ju mbulojë hundën dhe gojën.

Sa gjatë do të më duhet të pres midis dozës së parë dhe dozës së dytë të vaksinës COVID-19 të Pfizer, Moderna ose Novavax? ()

Doza e dytë rekomandohet të bëhet pas 21 ditësh për Pfizer dhe Novavax dhe 28 ditësh për Moderna, por çdo kohë deri në 6 javë diferencë (42 ditë) pas dozës së parë pajtohet me direktivat e CDC. Nuk duhet ta merrni dozën e dytë më herët se 21 ditë për Pfizer ose Novavax ose 28 ditë për Moderna. Vakcina Janssen (Johnson & Johnson) jepet me një dozë të vetme.

Disa persona që nuk janë vaksinuar ende – të moshave 12 deri në 64 vjeç, të cilët nuk janë të imunokompromentuar në gjendje mesatare ose të rëndë, veçanërisht meshkujt e moshës 12 deri në 39 vjeç - mund të përfitojnë nga marrja e dozës së dytë të vaksinës së tyre mRNA COVID-19, 8 javë pas dozës së tyre të parë, në vend të afatit kohor të përmendur më sipër. Pyesni ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor për më shumë informacion.

Sa e efektshme është një dozë e një vaccine Pfizer, Moderna ose Novavax kundër COVID-19 në krahasim me dy dozat?

Vaksinat Pfizer, Moderna dhe Novavax kundër COVID-19 nuk janë studiuar për përdorim si një dozë e vetme. Njerëzit duhet t'i marrin të dyja dozat e vaksinës, pra të vaksinohen plotësisht, që vakcina të jetë e efektshme.

A do të monitorohem pasi të vaksinohem?

Personat që kanë pasur shok anafilaktik (reaksion të rëndë alergjik) për çdo arsye, do të mbahen nën vëzhgim për 30 minuta. Të gjithë të tjerët do të monitorohen për 15 minuta.

A do të marr ndonjë dokument që të shërbejë si provë e vaksinimit?

Duhet të merrni një kartë ose fletë vaksinimi, që ju informon se çfarë vaksine COVID-19 keni bërë, datën kur e keni bërë dhe ku e keni bërë. Sigurohuni që ta mbani këtë kartë se do t'ju duhet për dozën e dytë. Mund të nxirrni një foto të saj, për ta pasur si kopje digjitale rezervë.

Duhet të merrni edhe një version letër ose elektronik të një flete informative me të dhëna të mëtejshme për vaksinën specifike COVID-19 që po ju ofrohet. [Çdo vaksinë COVID-19 vjen me fletën e vet të fakteve](#), me informacion që ju ndihmon të kuptoni rreziqet dhe përfitimet nga marrja e asaj vaksine specifike.

Çfarë të bëj, po ta humb Kartën e Regjistrimit të Vaksinimit kundër COVID-19? (Përditësuar më 11 janar 2022)

Keni disa opsione:

1. Lidhuni me ofruesin e kujdesit tuaj shëndetësor ose me qendrën ku u vaksinuat. Ata mund të printojnë një kopje tjetër të kartelës suaj.
2. Merrni një kopje digjitale të të dhënave tuaja të vaksinimit përmes [MyVaxRecords.Mass.Gov](https://myvaxrecords.mass.gov).
3. Kartela juaj do të jetë edhe në [v-safe](#), në qoftë se jeni regjistruar në atë program.
4. Mund të plotësoni një [Formular të Kërkesës për Kartelën e Imunizimit](#), që shkon drejtpërdrejt te Departamenti i Shëndetit Publik i shtetit. Po të përdorni këtë formular, do të merrni një histori të plotë të të gjitha vaksinave që keni bërë, jo thjesht të vaksinës kundër COVID-19, dhe mund të duhen deri në 6 javë që ta merrni kartelën.
 - a. Ju lutemi vini re se kjo formë duhet të jetë e noterizuar para se të dorëzohet dhe postohet në kopje të shtypur. Ju do të merrni një regjistrim në letër për çdo imunizim që keni marrë dhe që është raportuar në MIIS. Ju nuk do të merrni një kartë vaksine COVID-19.

Nëse jeni vaksinuar në një vend vaksinimi masiv, shihni [udhëzime për kërkesat e regjistrimit të vaksinimit](#).

Pasi të vaksinoheni

Si të veproj nëse, pasi të kem bërë vaksinën COVID-19, të më shfaqen simptoma të tilla si ethet dhe dhimbjet e trupit?

Disa njerëz kanë efekte anësore pasi vaksinohen (të tilla si kapitje, dhimbje koke dhe dhimbje në vendin e vaksinimit), të cilat janë shenja normale që tregojnë se trupi juaj po ndërton mbrojtje. Këto efekte anësore mund të ndikojnë në aftësinë tuaj për të kryer veprimtari ditore, por duhet të largohen brenda pak ditëve. Nëse zhvillonit simptoma të rrugëve të frymëmarrjes,

si rrufë, kollë ose humbje të shqisës së nuhatjes ose të shijes, duhet të konsideroni që të testoheni për COVID-19 ose të flisni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor. Është e mundshme që të sëmurëni me COVID-19 edhe pasi ta keni bërë vaksinën. Rrini në shtëpi po të jeni sëmurë dhe shmangni kontaktin e afërt me të tjerët. Mund t'ju duhet të pyesni punëdhënësin tuaj, se si do të ndikojë kjo në marrëdhëniet tuaja të punës.

Nëse keni dhimbje ose shqetësime të konsiderueshme, bisedoni me mjekun tuaj, që mund të rekomandojë barna pa recetë, të tilla si ibuprofen ose acetaminofen. Për të pakësuar dhimbjen dhe shqetësimet në vendin ku është bërë vakina, mbulojeni zonën me një pecetë të pastër, të freskët dhe të njomur me ujë dhe përdoreni krahun ose ushtrojeni. Për të pakësuar shqetësimet nga ethet, pini shumë lëngje dhe vishuni lehtë. Në shumicën e rasteve, shqetësimet nga ethet ose dhimbja janë normale, por lidhuni me mjekun në qoftë se:

- skuqja ose pezmatimi i vendit ku e bëtë vaksinën shtohet pas 24 orëve
- efektet anësore ju shqetësojnë ose duket sikur nuk po largohen pas ca ditëve

Si të raportoj nëse kam ndonjë efekt anësor pasi të bëj vaksinën kundër COVID-19?

V-safe është një app për smartfon që përdor mesazhet tekst dhe anketat në ueb për të ofruar kontrolle shëndetësore të personalizuar pasi të jeni vaksinuar për COVID-19. Nëpërmjet v-safe, mund ta lajmëroni menjëherë CDC po të keni ndonjë efekt anësor pasi të bëni vaksinën kundër COVID-19. Sipas përgjigjeve që jepni, mund të merrni një telefonatë nga dikush nga CDC, për t'ju pyetur si ndiheni dhe për të marrë më shumë informacion. Dhe v-safe do t'ju kujtojë që të bëni dozën e dytë të vaksinës kundër COVID-19 nëse duhet. Për t'u regjistruar për v-safe, vizitoni [Verifikuesi i shëndetit V-safe pas vaksinimit | CDC](#).

Po të keni shqetësime, mund edhe t'i telefononi ofruesit të kujdesit shëndetësor. Ju ose ofruesi juaj mund t'i raportoni efektet anësore te Sistemi i Raportimit të Efekteve të Padëshiruara të Vaksinës (VAERS), një sistem mbarëkombëtar i administruar nga qeveria federale.

Sa kohë duhet të kalojë pasi ta bëj vaksinën COVID-19, që kjo të ketë efekt?

Zakonisht trupit i duhen disa javë që krijojë imunitet, pas vaksinimit. Kjo do të thotë se është e mundshme që një person të infektohet me virusin që shkakton COVID-19 menjëherë para ose pas vaksinimit dhe të sëmuret. Kjo ndodh sepse vakina nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për të ofruar mbrojtje. Do të konsideroheni si plotësisht i vaksinuar në qoftë se keni marrë dy doza të vaksinës Moderna, Pfizer ose Novavax kundër COVID-19, ose një dozë të vetme të vaksinës Janssen (Johnson & Johnson) më herët se 14 ditë më parë.

Sa kohë zgjat mbrojtja nga një vaksinë kundër COVID-19?

Nuk dihet ende se sa zgjat mbrojtja e vaksinës COVID-19. Studimet e fundit tregojnë se mbrojtja kundër virusit mund të ulet me kalimin e kohës. Kjo është arsyeja pse CDC rekomandon që grupe të caktuara të marrin një vaksinë përforcuese.

Kur mund të marr një dozë përforcuese?

Për informacione se çfarë janë dozat përforcuese, kush kualifikohet dhe si ta merrni një të tillë, vizitoni [pyetjet e bëra më të shpeshta për dozat përforcuese të Covid-19 | Mass.gov](#) ose [Dozat përforcuese të vaksinës COVID-19 | CDC](#).

Ekziston një mjet për t'ju ndihmuar të përcaktoni se kur ose nëse ju (ose fëmija juaj) mund të merrni një ose më shumë doza përforcuese të COVID-19. Është etiketuar "Zbuloni kur mund të merrni dozën tuaj përforcuese" dhe mund të gjendet në [Dozat përforcuese të Vaksinës COVID-19 | CDC](#)

A mund të marr një dozë të dytë përforcuese?

Për informacion se çfarë janë dozat përforcuese, kush kualifikohet dhe si të merrni një të tillë, vizitoni [Pyetjet më të shpeshta për dozat përforcuese të COVID-19 | Mass.gov](#) ose [Dozat përforcuese të Vaksinës COVID-19 | CDC](#)

Ekziston një mjet për t'ju ndihmuar të përcaktoni se kur ose nëse ju (ose fëmija juaj) mund të merrni një ose më shumë doza përforcuese të COVID-19. Është etiketuar "Zbuloni kur mund të merrni dozën tuaj përforcuese" dhe mund të gjendet në [Dozat përforcuese të Vaksinës COVID-19 | CDC](#)

Kush ka të drejtë të marrë një dozë shtesë të serisë primare?

Për informacion në lidhje me dozat e vaksinës, kush është i përshtatshëm dhe si të merret një dozë, vizitoni [Informacioni i vaksinës COVID-19 për Massachusetts | Mass.gov](#) ose [Qëndroni të përditësuar me vaksinat tuaja kundër COVID-19 | CDC](#) ose pyesni ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor për më shumë informacion.

Siguria e vaksinës

A është e sigurt vakcina Johnson & Johnson?

Të gjitha vaksinat në Shtetet e Bashkuara duhet të kalojnë nëpër tre faza të provave klinike për t'u siguruar që ato janë të sigurta dhe efektive. Të gjitha vaksinat kundër COVID-19 të përdorura në SHBA janë të sigurta dhe ofrojnë nivele të larta mbrojtjeje kundër sëmundjes së rëndë, shtrimit në spital dhe vdekjes.

Në shumicën e situatave, vaksinat Pfizer-BioNTech, Moderna ose Novavax COVID-19 preferohen ndaj vaksinës J&J/Janssen COVID-19 për vaksinimin parësor dhe përforcues për shkak të rrezikut të efekteve anësore serioze. Vakcina J&J/Janssen COVID-19 mund të merret në konsideratë në disa situata, duke përfshirë personat që:

- Patën një reaktion të rëndë pas një doze vaccine mRNA ose që kanë një alergji të rëndë ndaj një përbërësi të Pfizer-BioNTech ose Moderna (vaksinat mRNA COVID-19).
- Përndryshe do të mbeteshin të pavaksinuar për COVID-19 për shkak të aksesit të kufizuar në Pfizer-BioNTech ose Moderna (vaksinat mRNA për COVID-19).

- Dëshirojnë të marrin vaksinën J&J/Janssen COVID-19 pavarësisht shqetësimeve të sigurisë.

Për më shumë informacion vizitoni [Përmbledhje dhe siguria e vaksinës së Johnson & Johnson's Janssen COVID-19 | CDC](#)

Si ta dimë që vakcina është pa rrezik?

Ka rëndësi të dihet se vaksinat testohen më shumë se çdo preparat tjetër farmaceutik. Më parë, vakcina e provës u jepet grupeve të vogla të njerëzve. Pastaj, vakcina u jepet njerëzve me karakteristika të caktuara (p.sh. moshë, raca dhe shëndeti fizik). Më pas, vakcina u jepet dhjetëra mijëra vetëve, për t'u testuar për efektshmëri dhe siguri.

Pas kësaj, [Komiteti Këshillues i CDC për Praktikën e Imunizimit](#) (ACIP) i shqyrton të dhënat, për të parë nëse vakcina punon dhe është e sigurt. Ata këshillojnë Administratën e Shteteve të Bashkuara për Ushqimin dhe Barnat (FDA). FDA-ja studion të dhënat dhe këshillat që jep ACIP dhe vendos nëse do ta miratojë vaksinën. Vakcina miratohet vetëm kur të jenë marrë **të gjitha këto masa**, dhe ekspertët të sigurohen se ajo punon dhe është e sigurt.

Vizitoni [Siguria e Vaksinave kundër COVID-19 në Shtetet e Bashkuara | CDC](#) për më shumë informacion.

Si mund të jetë e sigurt vakcina, nëse u zhvillua kaq shpejt?

Afati për të zhvilluar një vaksinë kundër COVID-19 u përshpejtua, por asnjëherë nuk u bënë kompromise për sigurinë. Dhe ja si:

1. **Ne kishim tashmë informacion të dobishëm:** Virusi COVID-19 është pjesë e një familjeje koronavirusesh që është studiuar për një kohë të gjatë. Ekspertët mësuhan shumë gjëra nga epidemitë e shkaktuara nga koronaviruset e tjera, që u shërbyen për të zhvilluar vaksinën kundër COVID-19, në mënyrë që të shmangnin nisjen nga zeroja.
2. **Zhvillimi i vaksinës përfitoi nga fondet shtetërore:** Shtetet e Bashkuara dhe shtete të tjera investuan fonde të mëdha për të mbështetur përpjekjet e kompanive të vaksinave. Bashkëpunimi mes vendeve të ndryshme i ka ndihmuar studiuesit të bëjnë përparime të shpejta.
3. **Një numër i madh njerëzish morën pjesë në provat klinike:** Shumë vetë u treguan të gatshëm të ndihmojnë, duke u ofruar të marrin pjesë gjatë fazës kur u studiuhan vaksinat. Kompanive nuk iu desh të shpenzonin kohë për të gjetur vullnetarë.
4. **Prodhimi i vaksinës u ndërмор njëkohësisht me studimet e sigurisë:** Kompanitë e vaksinave arritën të prodhojnë dhe të magazinonin doza të vaksinës njëkohësisht kur po kryeshin studime (të njohura edhe si prova klinike) për të treguar se vaksinat ishin të sigurta dhe të efektshme. Kjo do të thotë se vaksinat ishin gati për t'u shpërndarë sapo morën miratimin.

Si mund të jetë e sigurt vakcina, kur ne nuk i njohim efektet anësore afatgjatë?

Vaksinat Pfizer dhe Moderna kundër COVID-19 janë nga ato që ekspertët i quajnë vakcina të lajmëtarit RNA, ose shkurt, mRNA. Vakcina Janssen (Johnson & Johnson) quhet vaksinë me

vektor viral. Të dy llojet e vaksinave janë studiuar në prova me kafshë dhe njerëz për vite me radhë. Nga ana tjetër, COVID-19 është shfaqur vetëm para rreth një viti dhe efektet anësore afatgjatë të infeksionit nga COVID-19 janë përgjithësisht të panjohura dhe mund edhe të jenë serioze. Prandaj vaksinimi është gjëja më e mirë që mund të bëni, për shëndetin dhe sigurinë tuaj afatgjatë.

Novavax është vakcina e parë me nën-njësi proteinash COVID-19 që CDC ka rekomanduar për përdorim në Shtetet e Bashkuara. Vaksinat me nën-njësi proteinike përmbajnë copa (proteina) të padëmshme të virusit COVID-19 së bashku me një përbërës tjetër të quajtur ndihmës që ndihmon sistemin imunitar t'i përgjigjet virusit në të ardhmen nëse ekspozohet. Vaksinat që përdorin nën-njësi proteinash janë përdorur për më shumë se 30 vjet në Shtetet e Bashkuara, duke filluar me vaksinën e parë të licencuar të hepatitit B. Vaksinat e tjera të nën-njësi proteinike të përdorura sot në Shtetet e Bashkuara përfshijnë ato për të mbrojtur kundër gripit dhe kollës së mirë (kollës së mirë).

Ekspertët do të vazhdojnë të gjurmojnë efektet anësore të vaksinës kundër COVID-19. Pjesëmarrësit në provat klinike do të gjurmohen për 2 vjet. Persona të tjerë që vaksinohen mund të përdorin një vegël të quajtur **v-safe** në smartfonët e tyre, për ta njoftuar menjëherë CDC-në nëse kanë ndonjë efekt anësor, pasi ta kenë bërë vaksinën kundër COVID-19. Përdoruesit e V-safe mund të bashkëndajnë informacion për deri një vit pas vaksinimit. Mësoni më shumë te [V-safe Kontrolluesi i shëndetit pas vaksinimit](#).

A kanë efekte anësore vaksinat kundër COVID-19?

Disa persona mund të kenë efekte anësore pasi vaksinohen, meqë këto janë shenja normale se trupi juaj po krijon mbrojtje. Këto efekte anësore mund të ndikojnë në aftësinë tuaj për të kryer veprimtari ditore, por duhet të largohen brenda pak ditëve. Efektet anësore më të zakonshme janë minore dhe përfshijnë kapitjen, dhimbjet e kokës, dhimbjet në vendin e injeksionit, dhimbje të muskujve ose të kyçeve, të ngjethëta, të përziera dhe/ose të vjella dhe ethe. Për më shumë informacion shihni [Efektet anësore të mundshme pas marrjes së një vaksine COVID-19 | CDC](#)

A mundet që një vaksinë kundër COVID-19 të më sëmurë me COVID-19?

Jo. Vaksinat Pfizer, Moderna, Novavax dhe Janssen (Johnson & Johnson) nuk përmbajnë virus të gjallë, që shkakton COVID-19. Kjo do të thotë se një vaksinë COVID-19 nuk mund t'ju sëmurë me COVID-19. (burimi: [Fakte për Vaksinat kundër COVID-19 \(cdc.gov\)](#)). Prandaj, nëse testoni pozitiv për COVID-19, edhe po ta keni bërë vaksinën, do t'ju duhet të izoloheni.

A duhet ta bëjë vaksinën COVID-19 dikush që ka një histori alergjik?

Po të keni një histori reaksionesh alergjike serioze (të njohur edhe si shok anafilaktik) ndaj cilitdo përbërësi të vaksinës, nuk duhet t'i bëni vaksinat Pfizer, Moderna, Novavax ose Janssen (Johnson & Johnson) kundër COVID-19. Po të keni pasur reaksion alergjik të rëndë ndaj diçkaje tjetër, që nuk gjendet në vaksinë, diskutojeni këtë me ofruesin e kujdesit shëndetësor para se ta bëni vaksinën.

Edhe pse ka një shans të vogël që vaksinat kundër COVID-19 të shkaktojnë një reaktion të rëndë alergjik, kjo do të ndodhë zakonisht brenda pak minutash deri në një orë pasi ta keni bërë vaksinën. Të gjithë, edhe ata që nuk vuajnë nga ndonjë alergji, do të monitorohen për së paku 15 minuta pasi ta bëjnë një vaksinë kundër COVID-19.

Cilët janë përbërësit e vaksinës?

Përbërësit e vaksinës COVID-19 konsiderohen të sigurt për shumicën e njerëzve. Pothuajse të gjithë përbërësit në vaksinat kundër COVID-19 janë përbërës që gjenden në shumë ushqime – yndyrna, sheqerna dhe kripëra. Përbërësit e saktë të vaksinës ndryshojnë sipas prodhuesit. Vaksinat Pfizer dhe Moderna për COVID-19 përmbajnë gjithashtu ARN mesazhere (mRNA), vaksinat Novavax COVID-19 gjithashtu përmbajnë copa (proteina) të padëmshme të virusit që shkakton COVID-19 dhe vakcina Johnson & Johnson/Janssen COVID-19 përmban një version të padëmshëm të një virusi që nuk ka lidhje me virusin që shkakton COVID-19. Të gjitha këto u japin udhëzime qelizave në trupin tuaj për të krijuar një përgjigje imune. Kjo përgjigje ju ndihmon të mbron që të mos sëmurëni me COVID-19 në të ardhmen. Pasi trupi prodhon një përgjigje imune, ai i largon të gjithë përbërësit e vaksinës ashtu siç do të hidhte çdo informacion që qelizat nuk kanë më nevojë. Ky proces është pjesë e funksionimit normal të trupit. Vaksinat kundër COVID-19 NUK përmbajnë përbërës si konservues, inde (si qelizat fetale të abortuara), antibiotikë, proteina ushqimore, ilaçe, latex ose metale.

Kam ndërmend që një ditë të bëj fëmijë. A është pa rrezik për mua që ta bëj vaksinën kundër COVID-19? ()

Po. CDC rekomandon vaksinimin kundër COVID-19 për njerëzit që përpiqen të mbeten shtatzënë tani, ose që mund të mbeten shtatzënë në të ardhmen. Nuk ka asnjë dëshmi që antitruapat e prodhuar pas vaksinimit COVID-19 ose se përbërësit e vaksinës do të shkaktojnë ndonjë problem me mbetjen shtatzënë tani ose në të ardhmen. Në fakt, nuk ka dëshmi se ndonjë vaksinë, përfshirë vaksinat COVID-19, shkaktojnë probleme të fertilitetit tek gratë ose burrat. Mësoni më tepër në [Vaksinat kundër COVID-19 për njerëzit që duan të kenë një fëmijë | CDC](#).

A mund ta bëjë vaksinën kundër COVID-19 dikush që është shtatzënë ose që po ushqen foshnjën në gji? ()

Po. [CDC](#) dhe [Kolegji Amerikan i Obstetërve dhe Gjinekologëve](#) rekomandon vaksinimin COVID-19 për njerëzit që janë shtatzënë ose ushqejnë me gji. Infeksioni COVID-19 gjatë shtatzënisë rrit rrezikun e sëmundjeve të rënda dhe lindjes së parakohshme. Dëshmitë në lidhje me sigurinë dhe efektivitetin e vaksinimit kundër COVID-19 gjatë shtatzënisë janë rritur. Të dhënat sugjerojnë se përfitimet e marrjes së një vaccine COVID-19 tejkalojnë çdo rrezik të njohur ose të mundshëm të vaksinimit gjatë shtatzënisë.

Vaksinimi është një zgjedhje personale për njerëzit që janë shtatzënë ose ushqehen me gji. Nëse keni pyetje, diskutoni vaksinimin me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor.

A janë vaksinat kundër COVID-19 të sigurta për fëmijët?

Po. CDC rekomandon që të gjithë personat e moshës 6 muajsh e lart të marrin një vaksinë COVID-19. Shkencëtarët kanë kryer prova klinike me mijëra fëmijë dhe kanë përcaktuar se ajo është e sigurt dhe efektive. Mësoni më tepër:

- [Siguria e vaksinës COVID-19 tek fëmijët dhe adoleshentët | CDC](#)
- [Vaksinimet ndaj COVID-19 për personat e moshës 12-17 vjeç](#)
- [Vaksinimet ndaj COVID-19 për fëmijët e moshës 5-11 vjeç](#)
- [Vaksinimet kundër COVID-19 për fëmijët nga 6 muaj deri në 4 vjeç](#)

A do të ma ndryshojë DNA-në vaksina kundër COVID-19?

Jo. Vaksinat kundër COVID-19 nuk e ndryshojnë DNA-në tuaj dhe as ndërveprojnë me të në ndonjë mënyrë.

Vaksinat i mësojnë sistemit tonë imunitar si të luftojë kundër një virusi specifik. Ato bashkëpunojnë me mbrojtjet natyrore të trupit, për të zhvilluar, pa rrezik, imunitetin ndaj sëmundjes. Për ta arritur këtë efekt, vaksina kundër COVID-19 nuk ka nevojë të futet brenda bërthamës së qelizës, ku gjendet DNA-ja. Kjo do të thotë se vaksina nuk ndërvepron asnjëherë me DNA-në tonë dhe nuk ka si ta ndryshojë.

Në fund të procesit, trupi ynë ka mësuar si të mbrohet ndaj infektimit në të ardhmen. Ajo përgjigje imunitare dhe prodhimi i antitropave na mbron nga infeksioni, në qoftë se ndodh që të na hyjë në trup virusi real. (burimi: [Fakte rreth vaksinave kundër COVID-19 \(cdc.gov\)](#)).

Informacion i mëtejshëm

Vizitoni këto faqe ueb që përditësohen shpesh, të Qendrave për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC), për vaksinimin kundër COVID-19:

- [Përfitimet e vaksinimit kundër COVID-19](#)
- [Si punojnë vaksinat kundër COVID-19](#)
- [Mite dhe fakte rreth vaksinave kundër COVID-19](#)
- [Pyetje që bëhen shpesh rreth vaksinimit kundër COVID-19](#)